

STATUT
i
Federatës Shqiptare të Sportit
Universitar

Miratuar në Tiranë, datë 7 Shkurt 2025

Asambleja e Përgjithshme e FSHSU

TABELA E PËRMBAJTJES

	Faqe
KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Forma ligjore, përbërja, selia	4
Neni 2 Flamuri, emblema dhe logo	4
Neni 3 Qëllimi dhe funksionet	4
 KREU II ANËTARËSIA	 6
Neni 4 Anëtarësia	6
Neni 5 E drejta e fitimit të anëtarësisë	6
Neni 6 Të drejtat e anëtarëve	6
Neni 7 Detyrimet e anëtarëve	7
Neni 8 Pezullimi	7
Neni 9 Përjashtimi	7
Neni 10 Humbja e statusit të anëtarit	8
Neni 11 Dorëheqja e anëtarit	8
 KREU III ORGANIZIMI	 8
Neni 12 Organet e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar	8
Neni 13 Asambleja e Përgjithshme	9
Neni 14 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme	9
Neni 15 Emërimi i delegatëve	9
Neni 16 Numri dhe përcaktimi i delegatëve	10
Neni 17 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme	10
Neni 18 Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme	10
Neni 19 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme	11
Neni 20 Vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme	11
Neni 21 Drejtimi i Asamblesë së Përgjithshme	12
Neni 22 Zgjedhjet	12
Neni 23 Presidenti	12
Neni 24 Detyrat e Presidentit	13
Neni 25 Zëvendëspresidenti	13
Neni 26 Komiteti Drejtues	14
Neni 27 Kohëzgjatja e mandateve	14
Neni 28 Mbledhjet	14
Neni 29 Kompetencat e Komitetit Drejtues	15
Neni 30 Vendimmarrja e Komitetit Drejtues	15

KREU IV	SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM	16
Neni 31	Sekretari i Përgjithshëm	16
Neni 32	Përfshirja e një anëtar	16
KREU V	FINANCA	17
Neni 33	Periudha financiare	17
Neni 34	Burimet financiare	
KREU VI	DISPOZITAT E FUNDIT	17
Neni 35	Ndryshime	17
Neni 36	Hyrja në fuqi	18

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore, përbërja, selia

1. Federata Shqiptare e Sportit Universitar (për efekt të këtij Statuti më poshtë do t'i referohemi FSHSU) është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të Shoqatave Sportive Studentore dhe Universitare, sipas institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (për efekt të këtij Statuti më poshtë do t'i referohemi "Shoqatë"), që vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, Ligjit nr. 79/2017, "Për Sportin", i ndryshuar, si dhe në përputhje me akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Sportit Universitar anëtarësohet në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatën Evropiane të Sportit Universitar dhe Federatën Ndërkombëtare të Sportit Universitar dhe respekton statutet respektive, si dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët.
3. Selia e saj ndodhet në qytetin e Tiranës, Parku Olimpik "Feti Borova".

Neni 2

Flamuri, emblema dhe logo

1. Federata Shqiptare e Sportit Universitar mban siglën FSHSU.
2. Federata Shqiptare e Sportit Universitar ka stemën dhe flamurin e saj. Forma e logos është emërtimi i FSHSU.



3. Vula është në formë drejtkëndëshe me logon e Federatës FSHSU në qendër dhe poshtë shkruhet "Federata Shqiptare e Sportit Universitar".

Neni 3

Qëllimi dhe funksionet

1. Federata Shqiptare e Sportit Universitar është organizatë jofitimprurëse. Të ardhurat që krijohen për FSHSU nga burime të ndryshme ligjore investohen për zhvillimin e aktivitetit të FSHSU.
2. Federata Shqiptare e Sportit Universitar ka këto qëllime dhe funksione:

- a) të organizojë, drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive zyrtare me studentët e arsimit të lartë, në nivel rajonal e kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive, në bazë të rregulloreve të miratuara;
- b) të organizojë universiadat në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të universiteteve;
- c) të organizojë ekipet përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare të sportit universitar;
- d) të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “Kampionin Kombëtar” dhe “Ekipin Kampion Kombëtar” në sportin përkatës;
- e) të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin përkatës;
- f) të marrë masa për parandalimin e dhunës, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën;
- g) të përdorë simbolet e federatës ose të autorizojë përdorimin e tyre nga anëtarët e tjerë, për çdo qëllim;
- h) të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;
- i) të organizojë veprimtari zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin;
- j) të licencojë trajnerë për sportin përkatës;
- k) të japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive sportive, për anëtarët e saj dhe të nxisë zhvillimin e sportit nëpërmjet pjesëmarrjes në gara dhe evente ndërkombëtare;
- l) të zhvillojë marrëdhënie miqësore midis anëtarëve të federatës si dhe të mbrojë të drejtat e anëtarëve të saj dhe të kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive, duke u mbështetur në statutin, rregulloren e saj, legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe në aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit universitar;
- m) të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës sportive në institucionet e arsimit të lartë, për zhvillimin e aktiviteteve sportive, në përputhje me standardet bashkëkohore;
- n) të nxisë dhe promovojë zhvillimin e të gjitha disiplinave sportive, si dhe aktivizimin e ekipeve universitare dhe talenteve respektive;
- o) të shërbejë si koordinatorë, nxitëse dhe bashkëpunëtorë me organizmat qeveritare dhe joqeveritare qendrore dhe lokale për zhvillimin e lëvizjes fiziko-sportive në arsimin e lartë, në përputhje me Konventat Ndërkombëtare dhe Evropiane të fushës së sportit;
- p) të inkurajojë, regullojë dhe nxisë pjesëmarrjen e studentëve në nivele amatore dhe garuese, në aktivitete sportive-social-kulturore, si një faktor kyç në edukimin dhe formimin e tyre;
- q) të organizojë në Republikën e Shqipërisë, veprimtari sportive ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj, pas marrjes së miratimit nga ministria përgjegjëse për sportin;
- r) të promovojë të gjitha rezultatet e arritura nga studentët në disiplina të ndryshme sportive;
- s) të realizojë studime në fushën e sportit dhe aktivitetit fizik në bashkëpunim me institucionet përkatëse të kërkimit shkencor;
- t) të promovojë zhvillimin profesional të studentëve, trajnerëve, gjyqtarëve, vëzhguesve dhe aktorëve të tjerë në sportin Universitar;
- u) të bashkëpunojë me organizatat dhe subjektet e tjera që kanë për qëllim promovimin e sportit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

- v) të mbështesë zhvillimin e sportit universitar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - w) të drejtojë dhe të kujdeset për mbarrëvajtjen e të gjithë gjyqtarëve të FSHSU, kombëtarë e ndërkombëtarë, të aderuar në Federatë;
 - x) të organizojë seminare, trajnime, publikime në përputhje me dispozitat ligjore me qëllim zhvillimin dhe masivizimin e sportit.
3. Asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj, sipas Pikës 2 të Nenit 18 bazuar Ligjit 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar.
4. FSHSU njeh autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping, sipas Pikës 6 të Nenit 44 bazuar Ligjit 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar.

KREU II

ANËTARËSIA

Neni 4

Anëtarësia

1. Anëtarët e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar duhet të jenë persona juridikë, shoqata sportive, të cilat pranojnë aderimin pranë saj, duke respektuar statutin dhe rregulloret e funksionimit të FSHSU.
2. Anëtarët e regjistruar në FSHSU janë të detyruar të kontribuojnë për FSHSU nëpërmjet pagimit të kuotave të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Selitë e anëtarëve të FSHSU janë në territorin shqiptar.

Neni 5

E drejta e fitimit të anëtarësisë

1. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, shoqata kërkon të drejtën e anëtarësimit në Federatën Shqiptare të Sportit Universitar.
2. Komiteti Drejtues i jep shoqatës të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHSU deri në mbledhjen e ardhshme të Asambelsë së Përgjithshme.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë përderisa organizimi i kërkuesit nuk është në kundërshtim me statutin e FSHSU.

Neni 6

Të drejtat e anëtarëve

1. Anëtari i Federatës Shqiptare të Sportit Universitar ka të drejtë:
 - a) të pajiset me kartën e anëtarësimit;
 - b) të pajiset me statutin dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar;
 - c) të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme;
 - d) të informohet mbi vendimet e Komitetit Drejtues;

- e) të pajiset falas me botimet e ndryshme që bën Federata;
- f) të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon FSHSU;
- g) të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.

Neni 7

Detyrimet e anëtarëve

Detyrimet e anëtarit të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar janë:

1. Të mos të ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHSU.
2. Të paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj FSHSU.
3. T'i komunikojë FSHSU çdo ndryshim në statutet dhe rregulloret e anëtarit si dhe listën e personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta.
4. Të pranojë dhe t'u nënshtrohet statuteve dhe rregulloreve të Federatës Evropiane të Sportit Universitar dhe Federatës Ndërkombëtare të Sportit Universitar.
5. Për Asamblenë e veta të Përgjithshme të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe, nëse e gjykon të arsyeshme, edhe organin e vet disiplinor.
6. Të njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive.
7. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga këto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të Federatës.

Neni 8

Pezullimi

1. Shkelja e statutit, rregullores apo vendimeve të FSHSU i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHSU për një periudhë, e cila parashikohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Në raste urgjente, Komiteti Drejtues mund të japë pezullim provizor ndaj çdo anëtari që shkel statutin, rregulloren apo vendimet e FSHSU, deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme e cila do të shprehet me një vendim, për vendimin e Komitetit Drejtues.
3. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.
4. Humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërmblushura kundrejt FSHSU ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHSU, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FSHSU.
5. Pezullimi e përjashton anëtarin nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHSU, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FSHSU.

Neni 9

Përjashtimi

1. Shkelja e rëndë e statutit, regullores apo vendimeve të FSHSU, i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të përjashtojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHSU.
2. Përjashtimi sjell humbjen e statusit të anëtarit në mënyrë të pakthyeshme.
3. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që ta përjashtojë një anëtar kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të FSHSU.
4. Përjashtimi nuk e liron anëtarin nga detyrimet e veta financiare të papërmblusura kundrejt FSHSU ose anëtarëve të tjerë.

Neni 10

Humbja e statusit të anëtarit

1. Humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërmblusura kundrejt FSHSU ose anëtarëve të tjerë.

Neni 11

Dorëheqja e anëtarit

1. Anëtari mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje me kusht, që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më parë.

KREU III

ORGANIZIMI

Neni 12

Organet e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të FSHSU janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Presidenti;
 - c) Zëvendëspresidenti;
 - d) Komiteti Drejtues.
2. Komisionet e FSHSU janë:
 - a) Komisioni Teknik;
 - b) Komisioni i Financës;
 - c) Komisioni i Disiplinës;
 - d) Komisioni i Apelit;
 - e) Komisioni i Gjyqtarëve.
3. FSHSU njeh autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS), sipas Pikës 5 të Nenit 24 të Ligjit 79/2017, “Për Sportin”, i ndryshuar.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Federatës Shqiptare të Sportit Universitar. Vetëm një Asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj, të cilët përfaqësohen nga delegatët e tyre.
3. Në Asamblesë të Përgjithshme mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
4. Komiteti Drejtues vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Këta persona nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.

Neni 14

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e FSHSU ka këto kompetenca:

1. Miraton ndryshime të statutit të FSHSU në përputhje me Ligjin nr. 79/2017, “Për Sportin”, i ndryshuar.
2. Miraton llogaritë vjetore të Federatës.
3. Miraton raportin e Komitetit Drejtues të FSHSU.
4. Miraton buxhetin e FSHSU.
5. Miraton organin e kontrollit financiar të pavarur nga FSHSU sipas kuadrit ligjor në fuqi.
6. Përcakton numrin e plotë të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
7. Zgjedh Presidentin e Federatës.
8. Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues.
9. Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksionit të Federatës.
10. Miraton pranimin, pezullimin, përjashtimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut.
11. Heq mandatin e një anëtari apo të organeve të Federatës sipas parashikimit në këtë statut.
12. Deklaron shkrirjen e Federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
13. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga Komiteti Drejtues.

Neni 15

Emërimi i delegatëve

1. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHSU janë të detyruar të zgjedhin përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në këtë Asamble.
2. Anëtarët dërgojnë pranë federatës personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.

3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës që vërteton se ai është përfaqësues me të drejtë vote.
4. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (pasaportë/ ID).
5. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtar tjetër.
6. Anëtarët janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për t'u përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë Sekretariatit të FSHSU jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë.

Neni 16 **Numri dhe përcaktimi i delegatëve**

Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:

1. Çdo shoqatë ka 1 (një) delegat:
 - a) shoqata me përfaqësimin e 1000 deri 5000 studentë ka të drejtën e 1 (një) delegati shtesë;
 - b) shoqata me përfaqësimin e 5001 deri 7000 studentë ka të drejtën e 2 (dy) delegatëve shtesë;
 - c) shoqata me përfaqësimin e 7001 studentëve deri 9000 studentë ka të drejtën e 3 (tre) delegatëve shtesë;
 - d) shoqata me përfaqësimin mbi 9000 studentë ka të drejtën e 4 (katër) delegatëve shtesë;
2. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.
3. Nuk mund të përfaqësohen me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHSU persona që kanë qenë përfaqësues me të drejtë vote në një federatë tjetër.

Neni 17 **Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme**

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Drejtues ose Presidenti jo më pak se një herë në vit.
2. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
3. Rendi i ditës vendoset nga Komiteti Drejtues.
4. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Çdo anëtar ka të drejtën të propozojë përfshirjen e një çështjeje në rendin e ditës. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në Sekretariatit të FSHSU, 7 ditë përpara mbledhjes.

Neni 18 **Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme**

Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:

- a) verifikimi i përbërjes së mbledhjes;
- b) raporti i Presidentit;

- c) miratimi i raportit të aktiviteteve të Komiteti Drejtues;
- d) miratimi i raportit financiar;
- e) miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës;
- f) zgjedhjet për çdo vend vakant;
- g) shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e FSHSU;
- h) diskutime nga anëtarët për çështje të tjera;
- i) rendi i ditës mund të modifikohet nga një mazhorancë që përbën 2/3 e votave të shumicës (50%+1) para fillimit të punimeve të Asamblesë.

Neni 19

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme

1. Komiteti Drejtues mund të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 1/3 e delegatëve të Asamblesë së Federatës bëjnë kërkesë me shkrim, Komiteti Drejtues është i detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse asambleja nuk mbahet, anëtarët që e kërkuan atë mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune.
3. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara datës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet t'u dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Komiteti Drejtues vendos për rendin e ditës kur Asamblenë e thërret ai. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 së delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet për çfarëdolloj kushtesh.

Neni 20

Vendimmarria e Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1) që kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 24 orë pas të parës, me të njejtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë, përveç rasteve kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në statutin e FSHSU, si zgjedhja e Presidentit dhe e Komitetit Drejtues, lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të FSHSU, përjashtimi i një anëtari të FSHSU ose shkrirja e FSHSU, për të cilën kërkohet një mazhorancë prej 2/3 e votave të dala nga votimi i delegatëve të pranishëm.
3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Anëtarët ushtrojnë të drejtën e votimit të tyre përmes delegatëve të tyre zyrtarë. Një delegat nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.

5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese kur votimi është i hapur.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.
7. Vendimet e marra nga Asambleja hynë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë Komitetit Drejtues.

Neni 21 **Drejtimi i Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejohet nga Presidenti ose, në mungesë të tij, nga një zëvendëspresident. Kur edhe ai mungon, mbledhja drejohet nga anëtari më i vjetër i Asamblesë së Përgjithshme duke u emëruar Kryetar i ditës.
2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3-5 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejohet nga Sekretari Përgjithshëm, i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 20 ditëve mbas datës së mbledhjes.

Neni 22 **Zgjedhjet**

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet duhet të bëhen mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve të pranishëm në raundin e parë, dhe pastaj, në bazë të një numri më të madh të votave në raundin e dytë. Në rast se votat janë të njëjta bëhet një raund tjetër për të ndarë kandidatët, i cili përsëritet jo më shumë se tre herë. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e Presidentit të Federatës ka nevojë për (50%+1) të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin (50%+1) të votave, atëherë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh në raundin e parë kualifikohen për raundin tjetër. Në raundin tjetër, kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë atëherë zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 2.
4. Asambleja Zgjedhore zhvillohet sipas ciklit Olimpik.

Neni 23 **Presidenti**

1. Kandidati për president propozohet nga të paktën një anëtar i FSHSU, jo më vonë se 20 ditë para datës së Asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e Komitetit Drejtues.
2. Kandidati për President duhet:
 - a) të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;

- b) të ketë arsim të lartë sipas përcaktimeve të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- c) të ketë figurë të pastër morale;
- d) të ketë moshën mbi 30 vjeç;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- f) të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, profesor, pedagog, trajner, gjyqtar, gazetar, apo donator (financues).

Neni 24

Detyrat e presidentit

Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:

1. Të përfaqësojë FSHSU si i vetmi përfaqësues i saj.
2. Të kërkojë thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe të thërrasë mbledhjet e Komitetit Drejtues.
3. Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e Komitetit Drejtues.
4. Të sigurojë zbatimin e vendimeve Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues.
5. Në rast se Presidenti mungon, detyrat e tij mund t'i ngarkohen Zëvendëspresidentit.
6. Në rastin kur Presidenti jep dorëheqjen, Komiteti Drejtues cakton Zëvendëspresidentin të kryejë funksionet e Presidentit përkohësisht, deri në thirrjen urgjente të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

Neni 25

Zëvendëspresidenti

1. Zëvendëspresidenti emërohet nga Presidenti i FSHSU.
2. Zëvendëspresidenti shkarkohet nga Presidenti i FSHSU për shkelje të rënda statutore apo abuzime të tjera.
3. Zëvendëspresidenti duhet:
 - a) të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
 - b) të ketë arsim të lartë sipas përcaktimeve të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - c) të ketë figurë të pastër morale;
 - d) të ketë moshën mbi 30 vjeç;
 - e) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - f) të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, profesor, pedagog, trajner, gjyqtar, gazetar, apo donator;
 - g) të mos ketë konflikt interesi me të qenit Zëvendëspresident.
4. Detyrat kryesore të Zëvendëspresidentit janë:
 - a) të përfaqësojë FSHSU në takime kombëtare dhe ndërkombëtare kur Presidenti mungon;
 - b) të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur Presidenti mungon.
5. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e aktiviteteve që FSHSU zhvillon.
6. Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme dhe në takimet e Komitetit Drejtues.

7. Zëvendës-presidenti është anëtar i Komitetit Drejtues.

Neni 26

Komiteti Drejtues

1. Komiteti Drejtues përbëhet nga 7 (shtatë) vetë përfshirë Presidentin dhe anëtarët e tjerë.
2. Kandidati për anëtar i Komitetit Drejtues duhet:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë figurë të pastër morale;
 - c) të ketë arsim të lartë sipas përcaktimeve të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - d) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - e) të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federatë tjetër (anatër komisioni, kolegji etj);
 - f) të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, abuzimi financiar apo përdorim doping;
 - g) të jetë i propozuar nga një anëtar i federatës.
3. Anëtarët që propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
4. Emrat e kandidatëve, bashkë me kurrikulumin e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHSU. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet Komitetit Drejtues për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet delegatëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari Komiteti Drejtues duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave sipas kriterëve të përcaktuara në këtë statut.
5. Një anëtar i FSHSU mund të propozojë kandidatë për anëtarë në Komitetin Drejtues, sipas raportit të përcaktuar në nenin 16 të statutit.

Neni 27

Kohëzgjatja e mandateve

1. Mandati i Presidentit, Zëvendës-presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Drejtues është 4 (katër) vjeçar, që rinovohet vetëm 2 (dy) herë për 4 (katër) vjet.
2. Komiteti Drejtues plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të tij deri në përfundim të mandatit të anëtarit të cilin zëvendëson në mbledhjen e Asamblesë së rradhës nëpërmjet votimit, siç parashikohet në statut për zgjedhjet e FSHSU.

Neni 28

Mbledhjet

1. Komiteti Drejtues mbledhet jo më pak se tre herë në vit.
2. Mbledhja drejtohet nga Presidenti.

3. Presidenti bën njoftimin për mbledhje 7 ditë përpara zhvillimit të saj.
4. 1/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues i kërkojnë Presidentit mbledhjen e Komitetit Drejtues jashtë rradhe. Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tre) javëve pas marrjes së kërkesës.
5. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e Komitetit Drejtues pa të drejtë vote.
6. Mbledhjet e Komitetit Drejtues nuk mbahen në publik. Komiteti Drejtues mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHSU.
7. Për mbledhjet e Komitetit Drejtues mbahet procesverbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo anëtar që ka qenë pjesëmarrës në mbledhje.
8. Procesverbali i mbledhjes ruhet në arkivë në dy kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e procesverbalit, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.

Neni 29 **Kompetencat e Komitetit Drejtues**

Komiteti Drejtues ka këto kompetenca:

1. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHSU.
2. Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive.
3. Të përcaktojë për secilin punonjës të FSHSU specifikat e punës.
4. Të monitorojë administrimin e FSHSU.
5. Të përgatisë dhe të mbajë Asambleenë e Përgjithshme të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme.
6. Të hartojë projektbuxhetin.
7. Të emërojë dhe kur e shih të arsyeshme të shkarkojë anëtarët e Komisioneve të Përhershme.
8. Të përcaktojë, organizojë dhe anulojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar.
9. Të mbajë lidhje me organizata sportive kombëtare dhe ndërkombëtare dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FSHSU për t'u zgjedhur në këto organizata.

Neni 30 **Vendimmarrja e Komitetit Drejtues**

1. Komiteti Drejtues fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Komiteti Drejtues merr vendime me (50%+1) të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta, Presidenti ka votë vendimtare.
3. Në rast se një anëtar i Komitetit Drejtues ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet, ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje.
4. Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Komiteti Drejtues hynë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur Komiteti Drejtues vendos ndryshe.

KREU IV

SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

Neni 31

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretariati i Përgjithshëm është organi administrativ i FSHSU.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i FSHSU.
3. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet apo shkarkohet nga Presidenti i FSHSU për shkelje të rënda statutore apo abuzime të ndonjë natyre tjetër.
4. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë figurë të pastër morale;
 - c) të ketë arsim të lartë sipas përcaktimeve të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - d) të ketë aftësi të mira menaxhuese dhe organizative;
 - e) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - f) të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegjum etj.);
 - g) të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare;
 - h) të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze;
 - i) të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.
5. Funkcionet e Sekretarit të Përgjithshëm janë:
 - a) Të zbatojë vendimet e Komitetit Drejtues;
 - b) Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve;
 - c) Të përfaqësojë FSHSU në takime/aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare sportive;
 - d) Të programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të Komitetit Drejtues;
 - e) Të mbajë korrespondencën e FSHSU;
 - f) Të mbajë librat e llogarisë së FSHSU;
 - g) Sekretari i Përgjithshëm është drejtues i Sekretariatit të FSHSU;
 - h) Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e Sekretariatit të Përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brenda tij;
 - i) Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e Komitetit Drejtues dhe në ato të komiteteve këshilluese në një rol këshillues.

Neni 32

Përfashtimi i një anëtar

1. Asambleja e Përfjithshme mund të pezullojë një anëtar të Komitetit Drejtues për shkelje statutore, abuzime financiare apo për ndonjë shkelje tjetër.
2. Asambleja e Përfjithshme ka autoritetin që ta përfashtojë një anëtar kur propozimi për përfashtim votohet me 2/3 e anëtarëve që përbëjnë Asamblenë e Përfjithshme të FSHSU.
3. Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përfjithshme kërkon përfashtimin e Presidentit për një arsye të paraqitur në mocionin e mosbesimit, Asambleja e Përfjithshme ka autoritetin të marrë vendimin ose jo të përfashtimit, kur ky propozim votohet me 2/3 e anëtarëve të numrit të përfjithshëm që përbëjnë Asamblenë.
4. Mocioni i paraqitur nga 1/3 e anëtarëve për çfarëdo problemi qoftë, është detyruar për Komitetin Drejtues të Federatës për të mbledhur Asamblenë e Përfjithshme.

KREU V FINANCA

Neni 33 Periudha financiare

Periudha financiare do të jetë viti kalendarik.

Neni 34 Burimet financiare

Të ardhurat e FSHSU sigurohen nga:

1. Regjistrimet vjetore të anëtarëve.
2. Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHSU.
3. Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme.
4. Nga licencimi i trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, mjekëve, specialistëve, amatorëve, etj.

KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 35 Ndryshime

1. Çështjet që nuk parashikohen në këtë statut ose që ndodhin për arsye të forcave madhore, do të zgjidhen duke iu referuar dispozitave të Ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, Kodit Civil, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", si dhe duke iu referuar akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.

2. Çdo ndryshim i statutit të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar përpara se të regjistrohet në Gjykatën përkatëse, miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për sportin.

Neni 36
Hyrja në fuqi

1. Ky Statut është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e FSHSU.

PRESIDENT

Besnik Veliu

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Klea Taipllari